



NGO "VOICE OF ROMA,
ASHKALI AND EGYPTIANS
No. 18/26
Date: 18.03.2026



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur më dt. 26/03 2026, në mes:

Organizatës Jo-Qeveritare “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve” (në tekstin e mëtejshëm: *Organizata*), e përfaqësuar nga z. **Isak Skenderi**, Drejtor Ekzekutiv, me numër regjistrimi **5113364-1**, me adresë në rrugën “Rexhep Mala”, lagjja Aktash, **10000 Prishtinë**,

dhe

Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejshëm: *Komuna*), e përfaqësuar nga **Kryetari i Komunës së Vushtrrisë**, z. **Ferit Idrizi**,

Neni 1

QËLLIMI I MARRËVESHJES

Qëllimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi është përcaktimi i kornizës së bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Vushtrrisë dhe Organizatës Jo-Qeveritare “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve”, me synim vazhdimin dhe forcimin e funksionimit të Qendrës Mësimore me bazë në komunitet në Prelluzhë, në Komunën e Vushtrrisë, për periudhën Mars 2026 – Dhjetor 2028.

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, palët angazhohen të sigurojnë vazhdimësinë e ofrimit të shërbimeve arsimore për nxënësit nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian, përmes mbështetjes financiare dhe operative. Kjo përfshin, ndër të tjera, mbulimin e pagesës së tutorëve, pagesën e qirasë së hapësirës së Qendrës Mësimore, furnizimin me materiale për ngrohje, sigurimin e materialeve didaktike, si dhe realizimin e aktiviteteve mbështetëse që kontribuojnë në rritjen e pjesëmarrjes në arsim, përmirësimin e suksesit shkollor dhe parandalimin e braktisjes së shkollës.

Neni 2

QËLLIMET SPECIFIKE

2.1. Sigurimi i mbështetjes institucionale, financiare dhe menaxhimit të qendrës mësimore me bazë në komunitet në Prelluzhë në Vushtrri për periudhën **mars 2026 – dhjetor 2028**, përfshirë mbulimin e pagesës së tutorëve dhe shpenzimeve operative.

2.2. Regjistrimi dhe funksionalizimi i qendrave mësimore pranë Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.

2.3. Vazhdimi i zbatimit të programeve mësimore që synojnë përfshirjen e fëmijëve nga komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian në arsimin e rregullt.

2.4. Komuna siguron mbikëqyrjen e vazhdueshme të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në qendrat mësimore.

2.5. Ngritja e kapaciteteve për monitorim dhe cilësi të ofrimit të shërbimeve në qendrën mësimore nga organizata joqeveritare Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve.

Neni 3

KUSHTET DHE PARIMET E PËRGJITHSHME TË TË DYJA PALËVE

3.1. Komuna e Vushtrrisë dhe Organizata Jo-Qeveritare “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve” angazhohen të veprojnë në përputhje me legjislacionin dhe politikën në fuqi që rregullojnë funksionimin e Qendrave Mësimore, për periudhën Mars 2026 – Dhjetor 2028.

3.2. Palët angazhohen për bashkëpunim dhe koordinim të vazhdueshëm gjatë periudhës së vazhimit, duke siguruar mbështetje për tutorët dhe nxënësit.

Neni 4

OBLIGIMET E PALËVE

Në kuadër të kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi, palët angazhohen të respektojnë dhe përmbushin detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

4.1 Roli dhe detyrimet e Komunës së Vushtrrisë:

- Menaxhimin e Qendrës Mësimore me bazë në komunitet në Prelluzh, duke siguruar funksionimin sipas standardeve të MASHTI dhe udhëzimeve në fuqi, përfshirë:
 - Zbatimin e programit mësimor ekzistues për mësim plotësues;
 - Sigurimin e stafit dhe pagesën e tutorëve sipas dispozitave ligjore në fuqi;
 - Implementimin e rregullores së punës dhe masave për mbrojtjen e fëmijëve;
 - Zbatimin e planit të punës dhe planit financiar për periudhën e vazhimit.
 - Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në Qendër, duke përcaktuar personin përgjegjës për monitorimin.
- Komuna e Vushtrrisë angazhohet për planifikimin, sigurimin dhe mbulimin e mjeteve buxhetore për pagesën e tutorëve dhe stafit të angazhuar në Qendrën Mësimore, si dhe për të gjitha shpenzimet operative të saj, përfshirë qiranë e hapësirës, shpenzimet për ngrohje, materialet didaktike dhe aktivitetet mbështetëse, për periudhën Mars 2026 – Dhjetor 2028.
- Mbikëqyrjen dhe vlerësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në Qendër, duke përcaktuar personin përgjegjës për monitorimin dhe raportimin e vazhdueshëm.
- Planifikimin dhe ndarjen e buxhetit, duke siguruar vazhdimësinë e funksionimit të Qendrës.
- Raportimin e pjesës narrative dhe financiare pranë MASHTI, sipas udhëzimeve dhe standardeve në fuqi.

- Veprime të tjera mbështetëse që ndërlidhen me funksionimin e Qendrës Mësimore;

4.2 Roli dhe detyrimet e organizatës joqeveritare “Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve”:

- Organizata do t’i ofrojë komunës mbështetje teknike në procesin e aplikimit për regjistrimin e qendrës mësimore në MASHTI.
- Organizata do të investoj në ngritjen e shkathtësive dhe kapaciteteve të zyrtarëve komunal, koordinatorit të qendrës mësimore, dhe punonjësve të qendrës mësimore për aplikim sa më të mirë të standardeve të përcaktuara me UA për qendrat mësimore nga MASHTI.
- Organizata do të investojë në ngritjen e nivelit të komunikimit në mes të nivelit lokal dhe qendror për ndryshim ose vendim eventual të qendrave mësimore.
- Organizata do të kontribuojë në vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara në Qendër, duke raportuar tek Komuna për rekomandime dhe përmirësime të mundshme.

Neni 5 KOMUNIKIMI

Palët do të caktojnë nga një person kontakti që do të jenë përgjegjës për zbatimin e kësaj marrëveshje, me qëllim që komunikimi dhe shkëmbimi i informatave të jetë i shpejtë, konkret dhe i efektshëm.

Person kontakti nga Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve caktohet z. Bajram Ilazi, ndërsa nga Komuna e Vushtrrisë caktohet z.

Neni 6 ZBATIMI I MARRËVESHJES

Palët përgjigjen në mënyrë reciproke për përmbushjen e detyrimeve dhe kushteve të parashikuara në këtë marrëveshje bashkëpunimi.

Neni 7 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Në rast se në mes të palëve kësaj marrëveshje, paraqiten paqartësi apo mos pajtime, palët pajtohen se do të tentojnë t’i zgjidhin përmes bisedimeve.

Neni 8 KOHËZGJATJA

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe do të mbetet në fuqi deri më 31 Dhjetor 2028. Pas përfundimit të këtij afati, marrëveshja mund të rinovohet ose zgjatet me marrëveshje të nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 9

NDRYSHIMI/PLOTËSIMI I MARRËVESHJES DHE SHKËPUTJA E SAJ

- 9.1 Inicimi i ndërprerjes së kësaj marrëveshje mund të bëhet nga secila palë subjekt i kësaj marrëveshje bashkëpunimi me njoftim paraprak me shkrim, në afat prej tridhjetë (30) ditë para ndërprerjes ose zgjidhjes së marrëveshjes. Njoftimi paraprak me shkrim duhet të përmbajë sqarime të arsyetuara dhe të hollësishme mbi arsyet e shkëputjes së marrëveshjes së bashkëpunimit.
- 9.2 Llogaritja e kohës së njoftimit fillon nga data e pranimit të letrës njoftuese.
- 9.3 Deri në përfundimin e kësaj marrëveshje, palët do t'u përmbahen kushteve që rrjedhin nga kjo marrëveshje.

Neni 10

HYRJA NË FUQI DHE KOPJET E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij nga përfaqësuesit e palëve. Marrëveshja e bashkëpunimit përgatitet dhe nënshkruhet në dy (2) kopje origjinale në gjuhën shqipe, një (1) prej të cilave mbeten te Komuna dhe një (1) tek Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve

Kjo marrëveshje bashkëpunimi është nënshkruar me __/__/2026, në Prishtinë

Për dhe në emër të

Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptianëve




Isak Skenderi
Drejtor Ekzekutiv

Për dhe në emër të

Komunës së Vushtrrisë




Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës